



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prodato Received/Delivery	23. 12. 2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKMBIK	6307/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.Nr.975/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.Nr.975/2021 të datës 01.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rr.“Pajazit Islami”, Nr. 283, Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “ *kompensim material*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 22.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.975/2021 e datës 01.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 01.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim të shujtave ditore në vlerën prej 2 € për ditë pune, duke filluar nga 1 janari 2015 sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Më datë 10.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar

këto prova: Ankesën A.Nr. 975/2021 të datës 01.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 24.06.2021; vërtetimin e datës 09.06.2021; kërkesën e datës 07.06.2021, drejtuar Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm; Akt Emërimit të datës 12.10.2020; Përgjigjen në ankesë e datës 10.12.2021, me numër protokolli 6016/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 12.10.2020, është i emëruar në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Arteve Skenike, Muzikore dhe Pamore, pranë Departamentit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, i njëjti ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që Këshilli bazuar në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës ti njoh te drejtën e kompensimit të shujtës ditore në vlerë prej 2 euro për ditë pune, për periudhën nga 1 janari 2015 deri 31 dhjetor 2018, për ditët e punës sipas Vërtetimit me numër protokolli 1902/2021-48 të datës 09.06.2021 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MKRS-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilin janë ngritur pretendimet ankimore dhe ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 38/2014 më datë 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vite, respektivisht deri më datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Bazuar në konstatimin e lartcekur dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 01.12.2021 për realizimin e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punës për periudhën nga janari 2015 deri dhjetor 2018 është parashkruar, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë ligjore është i pabazuar.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej



tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.975/2021

Rushit KAJTAZI

[Signature]
Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ - DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

